



Datë: 09.07.2025
Numër Protokolli: 4661/2025

A.nr.98/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, dhe Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1541/2021 të datës 11.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.179/2024 të datës 02.05.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.314/2021 të datës 29.04.2021 të parashtruar nga ankuesi H.L të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Ramadan Shatri nga Istogu, kundër Vendimit KA.Nr.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike ‘*masë disiplinore-largim nga shërbimi civil*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.314/2021 e datës 29.04.2021 e parashtruar nga ankuesi H.L.

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.001/21 i datës 31.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, H.L, (tutje referuar vetëm ankuesi), 29.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. Prot:465/2021, kundër Vendimit KD.Nr.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore largim nga shërbimi civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektuar i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 07.05.2021 ka dërguar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.04.2021 e regjistruar më datë 29.04.2021 me numër protokolli 2064/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 28.04.2021 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Procesverbal i datës 29.03.2021 për intervistimin e ankuesit; Vendimin KD.NR.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ftesë për intervistë; Vendimin A.nr.59/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 19.03.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Flete kthesë e datës 06.04.2021; Kërkesë për përgjigje ne ankesë e datës 05.05.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 07.05.2021; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës e datës 09.06.2021; Vendimin VK.nr.27/2021 të datës 10.06.2021 të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 04.02.2021 me Nr. Prot:465/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 04.02.2021 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Vendimin me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Thirrje për intervistë e datës 13.01.2021; Vendimin me Nr. 276/20 i datës 19.12.2020 i Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e datës 21.06.2018; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin i datës 19.12.2020 i Policisë së Kosovës në Istog; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog e datës 25.01.2021; Pasqyra nga Banka Ekonomike; Vendim me Nr. 10/21 i datës 14.01.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese Dubravë; Kontratën e Punës së A.M; Certifikatën e Kolegjit Biznesi për A.M; Akt Emërimit e G.S; Certifikatën e Fakultetit Juridik për G.S; Vendimin e datës 14.10.2020 për caktimin e H.S si zëvendësues i Zëvendës Drejtorit të Qendrës Korrektuese Dubravë; Akt Emërimit e H.S; Diplomën e Kolegjit Juridica për H.S; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 13.01.2021 për ankuesin nga A.A; Raport Informativ i Sigurisë i datës 18.12.2020; E-mailin e datës 13.01.2021 nga H.S për A.A; Shkresë për gjetjet e kontrabandës tek Zyrtari Korrektues e datës 19.12.2020; Raport Informativ i Sigurisë i datës 21.09.2020 dhe 27.09.2019; Shkrese për Drejtorin; Fotot e datës 19.12.2020; Shkresë e datës 19.12.2020 nga Departamenti i Sigurimit; Raport Zyrtar i datës 19.12.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 10.02.2021 nga SHKK; Aktgjykimin A.nr.1541/2021 të datës 11.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin AA.nr.179/2024 të datës 02.05.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën e datës 25.01.2024 pranë Gjykatës së Apelit; Vendimin A.nr. 314/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka rishqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Fillimisht Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh Aktgjykimin A.nr.1541/2021 të datës 11.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.179/2024 të datës 02.05.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, konstaton se sipas ligjit të aplikueshme në kohë respektivisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, sipas nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar: *“1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civil me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”.*

Tutje sipas provave të lëndës, rrjedh se ankuesi sipas Kontratës për Kohë të Pacaktuar të datës 21.06.2018, mbante në pozitën “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në bazë të raportit të incidentit të datës 19.12.2020 të përgatitur nga Of. D.H në të cilin thuhet se: *“sot më datë 19.12.2020 Departamenti i Sigurimit ka bërë bastisje të organizuar me preke për stafin e ndërrimit të natës. Gjatë bastisjes rreth orën 07:40 në kuletën e zyrtarit korrektues H.L është gjetur një telefon mobil i tipit UNIHERTZ, modeli JELLY PRO me nr.serik:352897092518203 (Made in China) pa sin kartelë dhe jo i mbushur me bateri. Zyrtar korrektues H.L në momentin e bastisjes kuletën e tij nuk e ka futur në skener me qëllim që mos ti detektohet telefoni në skaner. Për rastin është njoftuar ZV. Drejtori H.S dhe Policia e Kosovës stacioni i Policisë në Istog të cilët kanë shoqëruar për në stacion Policor zyrtarin Korrektues H.L”, është iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit.*

Më datë 13.01.2021, nga Udhëheqësi i Njësisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme, është iniciuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor për shkak të shkeljeve disiplinore gjegjësisht për shkak se i njëjti më datës 19.12.2020 rreth orën 07:40 ka tentuar të fusë brenda institucionit korrektues telefon mobil.

Komisioni Disiplinor më datë 20.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 17/21/ me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore Largim nga Shërbimi Civil.

Ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.03.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.59/2021, përmes të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e shfuqizimet Vendimin me Nr. 17/21 të Komisionit Disiplinor dhe duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës që të bëjë shqyrtimin e rastit të ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke vepruar sipas udhëzimeve të vendimit A.nr.59/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2021 ka nxjerr Vendim KD.Nr.01/21, përmes të cilit ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik duke i shqiptuar masën disiplinore *Largim nga Shërbimi Civil*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se ky komisioni ka organizuar seancë disiplinore në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, me ankuesin dëshmitarët edhe iniciuesin e procedurës disiplinore dhe kjo sipas ankuesi është bërë me qëllimin nga frika se mos dëshmitarët do të deklaronin ndryshe; Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar me ankesë, është bazuar në deklaratën e dëshmitarëve dhe aspak nuk ka marr për bazë deklaratën e ankuesit se telefonin nuk e ka pasur për qëllim që të fusë brenda në burg por e ka harrur në kuletë dhe se telefoni ka qenë i djalit të tij, dhe aspak nuk ka tentuar që të fsheh kuletën dhe të gjitha konstatimet e dhëna nga Komisioni Disiplinor janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara. Kërkon që duke marr parasysh që asnjëherë nuk ka pasur vërejtjet në punën e tij, ankesa të aprovohet, të ndryshohet vendimi i komisionit disiplinor në atë mënyrë që masa e shqiptuar të ndryshohet në një masë për shkelje të lehta disiplinore. Të kthehet menjëherë në vendin e punës dhe të bëhet kompensimi nga dita e pezullimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike administrative, ju referuar dispozitave ligjore në fuqi të aplikueshme, konkretisht Ligjit Nr. 06/L114 për Zyrtarët Publik, më saktësisht dispozitave:

- Nenit 25 paragrafit 2 dhe 3, ku përcaktohet: 2. *Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.* 3. *Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”.*
- Nenit 28, përcaktohet: *Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.*
- Nenit 45, përcaktohet: 1. *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprim; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.*
- Nenit 46, përcaktohet: 1. *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore.* 2. *Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.* 3. *Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmblidhja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbledhjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbledhjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë.* 4. *Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Bazuar në përcaktimet ligjore të dispozitave si më sipër, dhe atyre që brendshëm në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që rregullojnë çështjen e etikës profesionale të zyrtarëve korrektues, Kolegji i Këshillit, bazuar në faktet e prezantuara, më konkretisht sipas raportit informativ zyrtar të datës 18.12.2020 është pranuar informata zyrtare se ankuesi do të sjell kontrabandë për të burgosurit, si rrjedhojë është organizuar edhe bastisje e të gjithë stafit, ndërsa ankuesit më datë 19.12.2020, në pikën e kontrollit pranë Qendrës Korrektuese në Dubravë gjatë kontrollës i është gjetur një telefon mobil i tipit UNIHertz, modeli JELLY PRO me nr.serik:352897092518203 (Made in China) pa sim kartelë dhe jo i mbushur me bateri kjo dëshmohet edhe në bazë të foto, duke mos e prezantuar se në kuletën e ti mban një telefon mobil.

Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve pranë Komisionit Disiplinor respektivisht në procesverbalin e datës 29.03.2021, dëshmitari S.F deklaroi se “...of. e parë që ka ardh ka qenë H.L. H. është nënshtruar dhe i ka nxjerr të gjitha sendet e ka nxjerr kuletën ka kalu dhe menjëherë e ka kap kuletën

e ka fut në xhep, unë i kam than se nuk bënë me fut në gjep pa e kontrolluar dhe e ka hap kuletën gjoja se nuk ka kurgjo...Të gjithë e kanë parë se në kulet është gjetur një telefon...”, po ashtu pranë Komisionit Disiplinor ka dëshmuar edhe L.B i cili ka deklaruar se: “...vetëm kuleta nuk është proceduar në skaner nuk e di pse nuk është vendosur në skaner. E ka urdhëruar z. H.L që ta nxjerr kuletën dhe e ka nxjerr telefoni ishte vendosur tek vendi i pareve të hekurit”, ndërsa deklarata e dhënë nga ankuesi pranë Komisionit Disiplinor ka qenë kundërtëdhënëse sepse i njëjti në një rast deklaroi se: “Djali ma ka dhënë me rregull një tel, e tel ska pas bateri as sim kartë dhe kem pas me rregullu”, ndërsa një rast tjetër deklaroi se “unë nuk kam qenë i sigurt se kam pas telefon me veti”, ndërsa më tutje deklaroi se: “unë deklaroj se e pranon se mu ka gjet telefoni dhe e pranoj se ka qenë gabim dhe kam kërkuar nga kolegët që të më falin gabimin... e pranoj se kam bërë gabim”.

Po ashtu për të vijuar tutje me prezantimin e fakteve dhe provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, ankuesi pranë Komisionit Disiplinor në seancë të tij më datë 29.03.2021 është pajtuar me përbërjen e komisionit dhe nuk kas pasur asnjë vërejtje për komisionin, e për rrjedhojë në seancë të komisionit disiplinor në pyetjen e anëtarit të komisionit K.K, *se a i dini rregullat që nuk lejohet më fut kurgjo në burg?* ankuesi deklaroi: *po i di rregullat*, dhe në pyetjen vijues të këtij anëtar *pse nuk e ki vendos kuletën në skaner?* ankuesi deklaroi se *unë e kam harruar se unë i di rregulloren dhe kam harruar pa ndonjë qëllim*.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës, deklaratimet e dëshmitarëve dhe ankuesit, konstaton se ankuesi në rastin e tij në ditën e ndodhjes së rastit nuk ka bërë asnjë përpjekje të vetme me qëllimin që mos të ndodhte rastin, sepse i njëjti i është shmangur edhe skanerit duke mos e vendosur kuletën përmes skanerit dhe telefoni i është gjetur vetëm në kohën kur i është bastisur kuleta, në këtë rast nënkuptohet fakti se ankuesi me qëllim dhe vetëdije ka tentuar të fus telefon brenda hapësirave të Qendrës Korrektuese në Dubravë dhe këtë e ka bërë duke i ditur rregullat e brendshme të institucionit që asnjëherë nuk lejohet që të futen sende të palejuara dhe i njëjtë në vend që të deklaroj se ka një telefon me vete i njëjti ka tentuar që t’i shmangej procedurave të kontrollit, për me tepër sipas dëshmitarëve i njëjtë e ka hapur kuletën dhe ka treguar vetëm tek pjesa e parave të letrës duke thënë se shikojeni nuk ka asgjë, e në këtë rast sipas Kolegjit, ankuesi ka tentuar të fsheh atë që ka pasur në kuletën e tij, e këtë e ka bërë plotësisht në kundërshtim me rregullat e brendshme të institucionit, sepse një gjë e tillë është rreptësisht e ndaluar me Rregulloren e Brendshme të Punës, me konkretisht me standardin e katërt pikë g ku thuhet: ***“fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sene të palejuara”***, kështu që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ MD-Nr.01 /2016 Kodi i Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues në Shërbimin Korrektues respektivisht parimeve të përcaktuar me nenin 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.

Në rastin konkret Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore, dhe edhe pse ankuesin në petitumin e ankesën kërkon që të ndryshohet masa disiplinore, çka nënkupton se ankuesi e pranon se ka kryer shkelje, por sipas Kolegjit shkelja e bërë nga ankuesi nuk përkon me shkelje të lehta disiplinore të përcaktuar sipas nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse shkelja e ankuesit nuk përben asnjë nga elementet e shkeljeve të lehta, por i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore të parashikuara sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Rrjedhimisht ankuesi me veprimet e tij për fshehjen e telefonit dhe mënyrën e fshehjes së tij duke mos e prezantuar dhe duke dhënë deklarata kundërtëdhënëse, ka plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore sipas nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase në rastin konkret ka ndodhur ekzistimi i veprimit të paligjshëm, sepse edhe pse ankuesi ka deklaruar se i ka ditur rregullat ka vepruar në kundërshtim me rregullat, veprimi i ankuesit është kryer me faj ngase ankuesi në këtë mes ka kryer shkelje sepse ka vepruar në

kundërshtim me rregullat ligjore dhe atyre të brendshme të institucionit, lidhur me pasojën dhe lidhjet shkakësore ndërmjet veprimet dhe dëmit, sipas provave të lëndës, bastisja është bërë si rezultat i paralajmërimit se ankuesi do të fuste një objekt të palejuar në hapësirat e institucionit dhe telefoni nuk ka arritur në destinacionin e përcaktuar jo për qëllimin e ankuesit por për shkak të parandalimit si rezultat i bastisjes.

Andaj Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimin KD.Nr.001/21 të datës 31.03.2021, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, sepse komisioni disiplinor, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, dhe në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi dhe si rezultat i konstatimit të drejtë të shkeljes disiplinore në mënyrë të drejtë dhe proporcionale ka shqiptuar edhe masën disiplinore ndaj ankuesit, e për rrjedhojë vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat e cekura më lartë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë të pabazuara.

Lidhur me çështjen se ankuesi është liruar nga përgjegjësia penale për rastin konkret, Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe përkundër faktit që ankuesi është liruar nga përgjegjësia penal, i njëjti për veprimet e tij mban përgjegjësi disiplinore dhe mbi këtë fakt lirimi nga përgjegjësia disiplinore nuk përbën asnjë shkak ligjor që i njëjti të lirohet edhe nga përgjegjësia disiplinore administrative sepse janë dy procedura të ndara dhe përjashtuese ndaj njëra tjetrës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.98/2024

Avdyl BEKTESHI

Eshref SHABANI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Ramadan Shatri;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së